Kronikë

Shkodër/ Dhunuan dje dhe bënë për spital 62 vjeçarin për një vendparkimi, identifikohen autorët dhe motivi! 1 në pranga, 5 në kërkim! I biri fshehu ngjarjen (EMRAT)

Për një vendparkim, 5 persona dhunuan me sende të forta 62 vjeçarin në mes të ditës në qytetin e Shkodrës.

Shkodër

Ergys Kavaja
4 Qershor, 10:09 | **Përditësimi: 4 Qershor, 10:38**

Share

SHKODER- Për një vendparkim, 5 persona dhunuan me sende të forta 62 vjeçarin, Vladimir Bruçi, në mes të ditës në qytetin e Shkodrës. Në pranga i cili ka përfunduar i biri është përpjekur të fshehë ngjarjen.

Ngjarja u shënua mesditën e 3 qershorit 2024 në rrugën "Pogej", në lagjen Rus, ndërsa policia informoi sot se ka identifikuar autorët, njëri prej të cilëve është arrestuar ndërsa 5 janë në kërkim.

U arrestua shtetasi Edmond Sakicaj, 47 vjeç dhe u shpallën në kërkim shtetasit Izmir Sakicaj, 23 vjeç, Samet Halluni, 27 vjeç, Arlind Kajoshi, 31 vjeç, Samuel Troshani, 24 vjeç dhe Alban Bruçi. 27 vjeç, të gjithë banues në Shkodër.

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Shkodër, një 62-vjeçar goditet me sende të forta në lagjen Rus, dërgohet me urgjencë në spital, policia në kërkim të autorëve(EMRI+VIDEO)

> *"Këta shtetas kanë goditur fizikisht dhe me sende të forta, gjatë konfliktit për vendparkimin e automjeteve, shtetasin Vladimir Bruçi, i cili vijon të jetë në kujdesin e mjekëve. Nga veprimet hetimore dyshohet se Sakicaj ka patur me vete armë zjarri, ndërsa shtetasi Alban Bruçi dyshohet se ka kryer veprime që pengojnë zbulimin e ngjarjes' informoi sot policia e Shkodrës.*

Vijon puna për kapjen e shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasja", kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municioneve" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

S.G/Shqiptarja.com

TAG: Vladimir Bruçi | Alban Bruçi | Samuel Troshani | Arlind Kajoshi | samet halluni | Izmir sakicaj | Shkoder

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Si ju duket programi i Bashës për zgjedhjet e 2025-ës?

Realist | I frytë | S'kam mendim

Lajme të tjera

Muriqan, arrestohen 3 shtetas turq, po tentonin të largoheshin me pasaportat e të tjerëve
2 Qershor, 11:56

Shkodër/ Rejna Koçi dhe Ameis Demiraj, dy fitueset e Festivalit Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë
Ergys Kavaja
2 Qershor, 10:35

'Ura e zezë' e Bunës, një tjetër grua vetëmbytet në lumë
1 Qershor, 18:46

Shkodër/ Arrestohet 37-vjeçari i shpallur në kërkim, Gjykata e Apelit e dënoi me 2 vite burg, ja arsyeja (EMRI)
1 Qershor, 12:13

Tre kërcënime ndaj gjyqtarit/ Tonin Stërkajt iu vendos bombë, i lanë një plumb dhe donin t'i hynin në shtëpi
31 Maj, 19:49

Akuzohet për pastrim parash dhe kontrabandë, Apeli heq sekuestron e pasurive të biznesmenit Ago Gjolajt
31 Maj, 17:32

Ishte pjesë e konfliktit me armë në Shkodër por nuk tregoi, arrestohet në Kakavijë
31 Maj, 13:20

Shkodër/ Goditen dy raste të kultivimit të kanabisit, nis hetimi për kreun e njësisë së Postribës, 43-vjeçari në Velipojë vihet në pranga
31 Maj, 11:43

Vau i Dejës kërkon të marrë turizmin në 'Lumin e Shalës', kryebashkiaku: Plehrat i pastrojmë ne, ndërsa taksat i vjel Shkodra
Ergys Kavaja
30 Maj, 15:34

Vetëmbytja e nënës me 3 fëmijët në Bunë, Apeli lë në burg bashkëshortin! Erdgys Arrazi shpërthen në lot: S'kam shkuar ende te varri i fëmijëve
30 Maj, 11:59

Shkodër/ Shisnin karta SIM me të dhëna false, të cilat përdoreshin nga krimi, 2 persona në hetim
30 Maj, 11:29

Video/ Përfshihet sërish në flakë spitali i Shkodrës, zjarri në bodrum te pompat e ujësjellësit! Shkak shkëndija elektrike
29 Maj, 19:45

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje